

Statuti i Shoqates “Shqiponjat Dardane”

NENI 1: Emërtimi & Ambleria

1. Emri i kësaj shoqate është: SHOQATA “SHQIPONJAT DARDANE”
2. Emblema e shoqatës është shqiponja dy krenare, motoçikleta dhe emri i shoqatës „SHQIPONJATDARDANE “.

NENI 2: Qëllimi

Qëllimi i Shoqatës “ShqiponjatDardane” është të zhvilloj tubime(takime)të motoçiklizmit Shqipëtar.Udhëtime, me pjesëmarrjen e anëtarve të saj në Zvicër .

NENI 3: Anëtarësia

1. Anëtarësia e shoqatës përbëhet nga persona të rritur, me pasion për sportin e motoçiklizmit, që zotërojnë të paktën një motoçikletë mbi 125 ccm, me dokumenta të regullta qarkullimi, dhe që janë të pajisur me lejen e posaçme për drejtimin e motoçikletave.
2. Pranimi dhe përjashtimi i anëtarit në apo nga shoqata bëhet sipas dispozitave të përcaktuara në Rregulloren e Shoqatës.

NENI 4: Pjesëmarrja

Çdo anëtarë i shoqatës ka për detyrë të marrë pjesë në të paktën një nga tubimet që organizon shoqata brenda një afati kohor një vjeçar. Tubimet e shoqatës organizohen sipas mënyrës së përcaktuar në Rregulloren e Shoqatës.

NENI 5: Kryesia e Shoqatës

Kryesia e Shoqatës është organi dretues i punës së shoqatës dhe përbëhet nga Kryetari, Nënkryetari, Sekretari, Arkatari . Procedura e zgjedhjes, funksioni dhe afati i detyrës së kryesisë është e përcaktuar në rregulloren e Shoqatës.

NENI 6: Burimet financiale të Shoqatës

1. Bazat financiale të shoqatës sigurohen nga anëtarësimi dmth. Shuma e caktuar e pagesës vjetore e çdo anëtarë.Donacionet mund të dhurojnë anëtarët, amatorët e sportit të motoçiklizmit, ose subjektët e tjera.Vlera materijale dhe deponimi i tyre në llogari bankare përcaktohen në Rregulloren e Shoqatës.
2. Fondi i Shoqatës përdoren për përmbushjen e kërkesave të saj. Anëtarët nuk mund të marrin shpërblim nga ky fond.
3. Shoqata “Shqiponjat Dardane” nuk është Shoqatë profitabile.

NENI 7: Pjesëmarrja në Shoqatë

Pjesëmarrja anëtarëve në Shoqatë zgjat aq sa zgjat egzistimi i saj me përjashtim të ndërprerjes së anëtarësimit nga vetë anëtari, ose për shkelje të Statutit ose të Regullores. Largimi i anëtarit nga pjesëmarrja në shoqatë bëhet sipas dispozitave të përcaktuara në rregullorren e Shoqatës.

NENI 8: Marrdhëniet me Shtypin, Mediat dhe Publikun

Zëri zyrtar i Shoqatës në lidhje me shtypin, Mediat dhe Publikun i rezervohet Kryetarit të Shoqatës, ose anëtarëve të tjerë të kryesisë së saj. Kryesia e Shoqatës ka të drejtën të jap intervista në lidhje me veprimtarinë e Shoqatës, si edhe të shpall lajmërimet e ndryshme për Shtypin, Median dhe Publikun.

NENI 9: Rregullorja e Shoqatës

Anëtarët e Shoqatës miratojnë një rregullore që nuk duhet të jetë në kundërshtim me Statutin e Shoqatës. Rregullorja mund të përmabajë dispozita shtesë për drejtimin e kësaj Shoqate. Rregullorja mund të ndryshojë sipas dispozitave të përcaktuara në të, me pëlqimin e shumicës të anëtarëve të Shoqatës.

Oftringen, më 03.11.2018